



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 590/3 Prot

Tiranë, më 13.10.2020

V E N D I M

Nr. 113, datë 13.10.2020

Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë, filluar në bazë të ankesës së paraqitur nga nëpunësi ***, për transferimin e padrejtë të tij nga pozicioni i punës si “*Veteriner*” për rrethin e Librazhdit, në të njëjtën detyrë në Njësinë Administrative Shushicë, në rrethin e Elbasanit, Institucioni Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe sqarimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me pretendimet për transferimin e pozicionit të punës në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil, të nëpunësit *****,

VËREJ SE:

Nëpërmjet shkresës me nr. 590 prot., datë 08.07.2020 është protokolluar ankesa e nëpunësit *****, përmes së cilës ngrihen pretendime mbi transferimin e tij nga pozicioni i punës si “*Veteriner*” për rrethin e Librazhdit, në Njësinë Administrative Shushicë, në rrethin e Elbasanit, në institucionin Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në fuqi.

Konkretisht, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se, punonjësi ***** ka qenë i punësuar prej vitit 2013 e në vijim, pranë Agjencisë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan, në pozicionin “*Specialist*”, në sektorin Veterinar, duke mbuluar si veteriner rrethin e Librazhdit. Me shkresën e datës 22.06.2020, me objekt:

“Njoftim”, të Drejtorit të Agjencisë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan, ky nëpunës është njoftuar se duke filluar nga data 25.06.2020, për nevoja pune, do të punojë në rrethin e Elbasanit dhe do të mbulojë Njësinë Administrative Shushicë.

Këtë akt, nëpunësi në fjalë e konsideron si një transferim të përkohshëm, të kryer në kundërshtim me përcaktimet e nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 17.02.2016, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, pasi nuk janë respektuar kriteret e nevojshme për vlefshmërinë e kryerjes së transferimit, të parashikuara në këto dispozita.

Gjithashtu, pretendohet se shkresa e datës 22.06.2020, me të cilën është njoftuar punonjësi *****, për transferimin e tij, ka mangësi formale në përpilimin e saj, mungojnë kërkesat e formës së aktit administrativ, sikurse janë baza ligjore; pjesa arsyetuese; dispozitivi i aktit; e drejta e ankimimit etj.

Nisur nga këto pretendime, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me parashtrimin e fakteve të mësipërme, me shkresën nr. 590/1 prot., datë 15.07.2020, me objekt: “Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e ankesës së punonjësit *****”, kërkoi nga institucioni Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan, sqarime si dhe praktikën shkresore që disponojnë për këtë rast, duke përfshirë dokumentacionin që materializon veprimet e kryera nga ana e institucionit.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan, me shkresën nr. 235 prot., datë 21.07.2020, me objekt: “Përgjigje tuajës nr. 590/1 prot., mbi pretendimet e nëpunësit ***** për transferimin e këtij punonjësi nga “Specialist Veteriner” në rrethin Librazhd, në njësinë Administrative Shushicë, në rrethin Elbasan”, e protokolluar pranë Komisionerit me nr. 590/2 prot., datë 24.07.2020, ka paraqitur sqarimet si dhe dokumentacionin e kërkuar për rastin në fjalë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, rezultoi se punonjësi ***** është nëpunës civil i konfirmuar, në pozicionin e punës “Specialist”, në sektorin Veterinar, në Drejtorinë e Bujqësisë Elbasan, me Vendimin nr. 17, datë 29.04.2015, (nr. 220/12 prot., datë 29.04.2015), të Drejtorit të këtij institucioni. Më pas, me shkresën nr. 6327/271 prot., datë 06.09.2018, të Departamentit të Administratës Publike, për shkak të ristrukturimit të institucionit është vendosur transferimi i përhershëm i nëpunësit ***** nga pozicioni “Specialist” në sektorin e Veterinarisë, Drejtoria e Bujqësisë Elbasan, kategoria IVb, në pozicionin “Specialist” në sektorin e Shërbimit Veterinar Elbasan, në institucionin Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar Elbasan, kategoria e pagës IVb, pozicion për të

cilin nëpunësi ka dhënë pëlqimin e tij me shkresën nr. 1248/1 prot., datë 03.10.2018, drejtuar Departamentit të Administratës Publike.

Në vijim, me shkresën e datës 22.06.2020, punonjësi ******, i emëruar në pozicionin “*Specialist*”, në sektorin e Shërbimit Veterinar Elbasan, për shkak të nevojës për kryerjen e shërbimit veterinar në Njësinë Administrative Shushicë, është urdhëruar nga titullari i institucionit, të kryejë detyrën e tij pranë kësaj njësie, në përputhje me objektivat e përcaktuara në përshkrimin e punës, praktikë kjo e ndjekur nga institucioni për të gjithë specialistët e sektorit të Shërbimit Veterinar, të cilët ngarkohen me punë brenda sektorit, në përputhje me detyrat dhe problematikat që krijohen në zona të ndryshme të territorit brenda juridiksionit të institucionit. Sipas dokumentacionit të administruar nga institucioni për rastin në fjalë, nuk rezulton që nëpunësi ******, të këtë kundërshtuar këtë urdhër të titullarit të institucionit.

Gjithashtu, sipas përgjigjes së ardhur nga institucioni Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan, rezulton se, nëpunësi ****** vijon punën në të njëjtin pozicion si “*Specialist*”, në sektorin e Shërbimit Veterinar Elbasan, i emëruar me aktin nr. 6327/271 prot., datë 06.09.2018, të DAP, ç’ka nënkupton se për këtë punonjës nuk është nxjerrë ndonjë urdhër transferimi i përkohshëm apo i përhershëm sipas përcaktimeve ligjore të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 17.02.2016, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, si rrjedhim urdhëri i datës 22.06.2020 është një akt i drejtuesit të institucionit Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan, i natyrës së organizimit të vazhdueshëm të punës, sipas nevojave që lindin në terren.

Natyra e akteve të tilla, diktohet nga mënyra e organizimit të institucionit në fjalë, në bazë qarku, sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 86, datë 13.06.2018, “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencive Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve*”, në të cilin përcaktohet se struktura e Agjencisë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan, do të jetë e ndërtuar në bazë të skemës 1/4 dhe 2/4, që i bashkëlidhen këtij urdhri. Në bazë të kësaj strukture dhe organigramës përkatëse, sektori i Shërbimit Veterinar, i Agjencisë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve, Elbasan, përbëhet nga një pozicion pune “*Përgjegjës Sektori*” dhe 18 pozicione pune “*Specialist*”, të cilët nuk janë të ndarë sipas qyteteve apo njësive administrative të veçanta për këtë qark, gjë e cila nënkupton se për mbulimin e nevojave të punës së përditshme, në gjithë sektorin e Shërbimit Veterinar Elbasan, specialistët mund të lëvizin nga një njësi administrative në tjetrën, pa u konsideruar kjo gjë, transferim i përkohshëm.

Më tej, në zbatim të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, të Këshillit të Ministrave, institucioni Agjencia

Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan ka miratuar përshkrimet e punës për secilin pozicion pjesë e organikës së saj, për pozicionin e punës “*Specialist*”, në sektorin e Shërbimit Veterinar, Elbasan, ku ndër detyrat kryesore është edhe investigimi në terren, në raste të caktuara si dhe përgatitja e raporteve mbi të dhënat e përfituara gjatë proceseve të monitorimit në terren.

Sa më lart, sa i takon aktit të datës 22.06.2020, të Drejtorit të Agjencisë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan, me anë të së cilit nëpunësi ***** , është urdhëruar që për nevoja pune, prej datës 25.06.2020 të mbulojë Njësinë Administrative Shushicë, vlerësohet se në të nuk evidentohen elementët e një akti transferimi sipas përcaktimeve ligjore të përmendura në kreun I, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 17.02.2016, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, por kemi të bëjmë me një akt të organizimit të përditshëm të punës, sipas nevojave që lindin në terren.

Në vlerësim të akteve ligjore dhe nënligjore arrihet në përfundimin se, pavarësisht që në këtë rast nuk evidentohen shkelje të dispozitave ligjore që rregullojnë institutin e transferimit siç pretendohet prej kërkuesit, njësia e burimeve njerëzore dhe drejtuesit e tjerë të njësive organizative, duhet të tregojnë kujdes që gjatë veprimtarisë së tyre të respektojnë kërkesat e pikës 2, të nenit 99, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, mbi elementët e aktit administrativ, me qëllim që përmbajtja e aktit të jetë e qartë dhe e kuptueshme për palët të cilëve i drejtohet.

Në përfundim, nga gjithë sa është parashtruar më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se pretendimi i ankuesit ***** , për transferimin në kundërshtim me ligjin, nga pozicioni i punës si “*Veteriner*” për rrethin e Librazhdit, në Njësinë Administrative Shushicë, në rrethin e Elbasanit, nuk është i bazuar në ligj, prandaj hetimi administrativ të përfundojë, dhe të arkivohet çështja.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe në nenin 34, pika 1, të Rregullores, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të ankesës nr. 590 prot., datë 08.07.2020, të paraqitur nga nëpunësi ***** , për transferim në pozicionin e

punës në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil, nga ana e drejtuesve të institucionit Agjensia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan dhe arkivimin e çështjes.

2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni Agjensia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha